

## OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2026

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT

Drejtuar: OE “ERXHEN” sh.p.k.

NIPT J67117044Q

Adresa: Shkoder, Lagjja Qemal Stafa, Rruga Arkitekt Sinani, me nr.pasurie 21820-N2, te zones kadastrale nr.8594.

- OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO X

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO X JO

Nëse po, të jepen dhënat: me Subjekt mbështetës “SULLOLLARI – KLIMA” NIPT K01529003M

Adresa: Tirane, Vaqarr, Rruga Arbanë, Vaqarr, me zone kadastrale 3712, nr.pasurie 19/18

Tipi i Kontratës: Shërbim

Lloji i Procedurës së prokurimit: “Procedure e hapur”, mbi kufirin e larte monetarë.

Numri i Procedurës: REF- 83173-04-23-2026.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Riparim, Mirëmbajtje sistemesh të ngrohje - ftohjeve për Spitalin Rajonal Shkodër” Marrëveshje Kuadër me afat 24 muaj, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

Fondi Limit: **30,532,813.33** (tridhjetë milion e pesëqind e tridhjetë e dy mijë e tetëqind e trembëdhjetë pikë tridhjetë e tre) lek pa TVSH

Kohëzgjatja e kontratës ose afati për zbatimin e saj: Marrëveshje Kuadër me afat 24 muaj, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara..

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 24.04.2026

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike Nr.29 date 27.04.2026.

#### KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1. OE “ERXHEN”** J67117044Q

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-t*

Vlera **26,748,350** (njëzetë e gjashtë milion e shtatëqind e dyzetë e tetë mijë e treqind e pesëdhjetë) **lekë pa TVSH;**

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO
- 2. OE “KEVIN KONSTRUKSION”** K71401004W

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-t*

Vlera: **21,831,582.80** (njëzetë e një milion e tetëqind e e tridhjetë e një mijë e pesëqind e tetëdhjetë e dy pikë tetëdhjetë) **lekë pa TVSH;**

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO
- 3. OE “ALTEC SHPK”** K57923807W

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-t*

Vlera: **26,042,432** (njëzetë e gjashtë milion e dyzetë e dy mijë e katërqind e tridhjetë e dy) **lekë pa TVSH;**

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- 1. OE “KEVIN KONSTRUKSION”** K71401004W

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-t*

***Për arsyt si me poshtë:***

Nuk permbush kriterin e vecante te kualifikimit piken 2.3.1 te Kapacitetit Teknik ku percaktohet:

*“Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të*

kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

- a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasisë e shërbimeve të realizuara.
- b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasisë e shërbimeve të realizuara”.

Konkretisht në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik ka ngarkuar në SPE kontrate sipërmarje Nr.3242/2 Prot, datë 02.09.2025 me objekt “Rikonstruksion i disa pavioneve të Spitalit Berat”, faturat tatimore dhe situacionet e punimeve perkatase për këtë kontratë. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga **“Kevin Konstruksion” Shpk, Nipt K71401004W** konstatohet që kjo kontratë dhe faturat tatimore i përkasin kategorisë së kontratës publike për punë, pasi përfshin një proces ndërtimor të plotë, ndërkohë kontrata objekt prokurimi është **“Kontratë Publike për Shërbime”**. Ligji i Prokurimit Publik parashikon qartë që kontrata publike për shërbime dhe kontrata publike për punë janë me natyrë krejt të ndryshme nga njëra tjetra, të cilat gjejnë rregullimin e tyre të posaçëm në LPP dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Rrjedhimisht faturat e dala nga një kontratë pune nuk mund të konsiderohen si të ngjashme me kontratën e shërbimit, pasi ndryshon kategoria ligjore, objekti dhe natyra e shërbimit/mallit që prokurohet. Sjellim në vëmendje që ky qëndrim është mbajtur dhe nga ana e KPP me vendimin Nr.1323/2025, datë 24.09.2025.

## 2. OE “ALTEC SHPK”

K57923807W

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-t*

### ***Për arsyet si me poshtë:***

Nuk përmbush kriterin e vecante te kualifikimit piken 2.3.6 te Kapacitetit Teknik pasi referuar Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të ngarkuar në SPE konstatohet që **“ALTEC” Shpk, Nipt K57923807W** ka vetëdeklaruar disponimin e **“1 (një) elektrikisti”** duke mos përmbushur kështu kriterin e sipërcituar i cili thote që:

*“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vërtetuar me kontratë punë të vlefshme si dhe te figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë: ”2 Elektricitist”*

**“Shënim:** Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST”

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë, : **OE “ERXHEN” sh.p.k** me NIPT J67117044Q me Subjekt mbështetës “SULLOLLARI – KLIMA” me NIPT K01529003M me adrese: Shkoder, Lagjja Qemal Stafa, Rruga Arkitekt Sinani, me nr.pasurie 21820-N2, te zones kadastrale nr.8594, me adrese: Tirane, Vaqarr, Rruga Arbanë,Vaqarr, me zone kadastrale 3712, nr.pasurie 19/18 se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **26,748,350** (njëzetë e gjashtë milion e

shtatëqind e dyzetë e tetë mijë e treqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.